

# HARTËZIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ZHVILLIM/ KAPACITETE TË ZGJERUARA INSTITUCIONALE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË KOSOVË



Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje Ekzekutive .....	6
Të Dhënat e Hapura të Qeverisë .....	9
Hartëzimi i të dhënave të prodhuara në institucionet publike qendrore në Kosovë .....	11
Analiza krahasuese me tri vende të Balkkanit Perëndimor .....	20
Analiza e shkaqeve të përdorimit të pakët të të dhënave dhe sistemeve për ndarje të të dhënave, dhe qasjet e rekomanduara për të përmirësuar mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave .....	23
Analiza tematike dhe gjetjet .....	24
Rekomandime .....	27
Faktorët për përdorimin e pakët të të dhënave në politikëbërje .....	27
Sistemet apo mekanizmat e mundshëm për të lehtësuar ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve publike qendrore dhe ASK-së .....	27
Qasjet për të përmirësuar mbledhjen, digjitalizimin, ndarjen dhe përdorimin e të dhënave për politikëbërje në mbarë institucionet publike qendrore të Kosovës .....	29
Metodologjia .....	31
Anekse .....	34

## **LISTA E ANEKSEVE**

<b>ANEKSI 1.</b> Institucionet publike qendrore të Kosovës .....	34
<b>ANEKSI 2.</b> Institucionet publike qendrore të tri vendeve të Ballkanit Perëndimor .....	44
<b>ANEKSI 3.</b> Dokumente për institucionet e Kosovës .....	46
<b>ANEKSI 4.</b> Dokumente për tri vendet e Ballkanit Perëndimor .....	51
<b>ANEKSI 5.</b> TKP-të për institucionet e Kosovës .....	54
<b>ANEKSI 6.</b> TKP-të për tri vendet e Ballkanit Perëndimor .....	73

## **LISTA E TABELAVE**

<b>TABELA 1.</b> Numri i dokumenteve dhe TKP-ve për ministritë e linjës .....	14
<b>TABELA 2.</b> Numri i dokumenteve dhe TKP-ve sipas llojit të institucionit dhe dokumentit.....	14
<b>TABELA 3.</b> Viti / periudha e mbledhjes së TKP-ve .....	15
<b>TABELA 4.</b> Numri i TKP-ve sipas burimit .....	16
<b>TABELA 5.</b> Gjithsej TKP sipas kategorive të ASK-së.....	17
<b>TABELA 6.</b> TKP të vetë-përzgjedhura sipas kategorive të ASK-së .....	17
<b>TABELA 7.</b> Institucion / Kategori i ASK-së për TKP të vetë-përzgjedhur .....	18
<b>TABELA 8.</b> Numri i dokumenteve dhe TKP-ve për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut për të tri ministritë e linjës .....	20
<b>TABELA 9.</b> Dokumente dhe TKP sipas llojit të dokumentit.....	20
<b>TABELA 10.</b> Vendet e krahasuara sipas numrit të TKP-ve për institucion dhe burimit.....	21
<b>TABELA 12.</b> Gjetjet e intervistave .....	32

## **LISTA E GRAFIKËVE**

<b>GRAFIKU 1.</b> Numri i dokumenteve dhe TKP-ve të mbledhura për secilin lloj të institucionit publik qendror në Kosovë .....	11
<b>GRAFIKU 2.</b> Dokumente dhe TKP për secilën ministri të linjës dhe agjenci .....	13

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të dhënat janë kryesore për politikën me qytetarin në qendër dhe qeverisje të mirë. Digjitalizimi u ka ofruar qeverive mundësi të konsiderueshme që të përmirësojnë efikasitetin dhe ofrimin e shërbimeve publike duke rritur gjithashtu transparencën dhe besueshmërinë. Digjitalizimi i komunikimit ka mundësuar publikimin e të dhënave publike institucionale përmes kanaleve zyrtare institucionale, si dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies duke i bërë të dhënat të qasshme për publikun.

Agjenda institucionale për të dhënat është në zgjerim në Kosovë<sup>1</sup>. Sidoqoftë, Kosova ende përballet me probleme thelbësore në zbatimin e të dhënave të hapura në Ballkanin Perëndimor. Institucionet Qendrore të Kosovës janë duke finalizuar Strategjinë e Agjendës Digjitale, e cila do të zbatohet për periudhën 8 vjeçare, ndërsa promovimi i qasjes në të Dhënat e Hapura të Qeverisë (DhHQ) përbën thelbin e objektivave të saj strategjike.<sup>2</sup> DhHQ-të shfaqen si nevojë për të promovuar një kulturë të drejtuar nga të dhënat në sektorin publik duke zhvilluar korniza që mundësojnë, udhëzojnë dhe nxisin qasjen për përdorimin dhe ripërdorimin e sasisë në rritje të të dhënave duke rritur hapjen dhe transparencën dhe duke nxitur angazhimin publik në politikëbërje dhe krijimin e vlerave publike.

Sipas gjetjeve të një studimi<sup>3</sup> për monitorimin në kohë reale të cilësisë së të dhënave të hapura në Ballkanin Perëndimor, disponueshmëria e formateve të të dhënave me cilësi të ulët duket se është shqetësimi më i madh që ndikon në ripërdorimin e të dhënave, duke rezultuar në një vlerësim mesatar 2.5/5 për cilësinë e të dhënave. Sipas udhërrëfyesit për pjesëmarrjen elektronike, qeverisjen e hapur dhe të dhënat e hapura në administratën publike<sup>4</sup>, Kosova ka krijuar me shpejtësi një e-strategji gjithëpërfshirëse dhe parime të qeverisjes së hapur; sidoqoftë, zbatimi ka qenë i pamjaftueshëm dhe progresi ka qenë i paktë meqë deri më sot nuk është konsideruar si prioritet kyç. Po kështu, një studim i kryer për aktivitetin dhe prezencën në rrjete sociale, sugjeron se Kosova është më pak e zhvilluar, krahasuar me pesë vendet e tjera të përfshira në qeverisjen elektronike dhe qeverisjen e hapur.

Këtu paraqitet një hartë e të dhënave të prodhuara në kuadër të institucioneve publike qendrore në Kosovë, duke analizuar të gjitha dokumentet publike që këto institucione ndajnë online. Duke vlerësuar se si ndahen të dhënat ndërmjet institucioneve publike dhe si përdoren ato në proceset e politikëbërjes, vlerësimi ofron një bazë për rekomandime për përdorim, mbledhje dhe menaxhim më të madh dhe efektiv të të dhënave nga institucionet në planin afatgjatë.

<sup>1</sup> Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

<sup>2</sup> Agjenda Digjitale e Kosovës 2022-2030

<sup>3</sup> Raça, V., Veljković, N., Velinov, G., Stoimenov, L., & Kon-Popovska, M. (2020). Monitorimi në kohë reale dhe vlerësimi i të dhënave të hapura të qeverisë: Një rast studimor i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në *Konferencën Ndërkombëtare për Inovacionet e TIK-ut* (fq. 189-201). Springer, Cham.


<sup>4</sup> Millard, J., Thomasen, L., Pastovic, G., Cvetkovic, B. (2018). Një udhërrëfyes për pjesëmarrje elektronike dhe qeverisje të hapur: dëshmi empirike nga Ballkani Perëndimor. Në punimet e Konferencës së 11-të Ndërkombëtare për Teorinë dhe Praktikën e Qeverisjes Elektronike, Galway, Irlandë, prill 2018 (ICEGOV'18). DOI: 10.1145/3209415,3209459

Gjithsej 64 dokumente nga institucionet e Kosovës kanë prodhuar së paku 261 shënime të Treguesve Kyç të Performancës (TKP)<sup>5</sup>.

Gjithashtu, janë shqyrtuar edhe 38 DOKUMENTE të tjera nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, me gjithsej 138 TKP. Të gjitha institucionet publike qendrore u kontrolluan për dokumente strategjike dhe disponueshmëri dhe përdorim të të dhënave. Kjo mundësoi mbledhjen e një sasive të konsiderueshme informacioni, i cili, së bashku me të dhënat cilësore nga intervistat me palët kyçe të interesuara, krijuan bazën për një krahasim të stadiut më të avancuar sa i përket disponueshmërisë, transparencës dhe përdorimit të të dhënave në kuadër të proceseve të politikëbërjes. Teksa Kosova paraqet një numër më të madh të dokumenteve dhe TKP-ve të mbledhura për secilën nga tri ministritë e linjës në krahasim me vendet e tjera, vlen të përmendet se Kosova ka numër më të lartë të TKP-ve që nxirren sipas llogaritjeve vetanake në vend që të përdoren burime të ndryshme (si p.sh. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ose opsionet ndërkombëtare).

Përveç hulumtimit, një element cilësor përfshinte 11 intervista për të analizuar shkaqet e përdorimit të pakët të të dhënave dhe sistemeve të ndarjes së të dhënave, dhe për të ofruar rekomandime për metodat për të përmirësuar mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave. Intervistat lejuan identifikimin e disa prej faktorëve kryesorë që pengojnë aftësinë institucionale për të mbledhur dhe shkëmbyer të dhëna. Këtu përfshihen mungesa e resurseve (financiare dhe njerëzore), mungesa e zyrave statistikore (si njësi organizative), si dhe mungesa e softuerit specifik për mbledhjen e të dhënave. Gjithashtu, është vërejtur se disa institucione qendrore nuk i përdorin treguesit e ASK-së, pasi nuk janë të posaçëm për punën e tyre.

Bazuar në analizë, ky raport jep disa rekomandime për sistemet apo mekanizmat e mundshëm për të lehtësuar ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve publike qendrore dhe ASK-së, dhe për qasjet për të përmirësuar mbledhjen, digjitalizimin, ndarjen e të dhënave dhe përdorimin e tyre për politikëbërje në mbarë institucionet e Kosovës. Gjetjet përputhen me Strategjinë Digjitale të UNDP-së<sup>6</sup>, duke sugjeruar katër shtylla të përmirësimit:



Nga kjo analizë janë nxjerrë rekomandimet e mëposhtme:

### **Korniza ligjore**

- Të përmirësohet kërkesa ligjore për shkëmbim të të dhënave për disa institucione publike<sup>7</sup>, për t'i shtyrë të shkëmbejnë të dhëna me ASK-në;

<sup>5</sup> Në këtë raport, TKP-të mendohen si tregues kritikë të publikuar në kuadër të dokumenteve duke përpunuar të dhënat nga ASK-ja apo ato të mbledhura prej saj dhe institucione të tjera.

<sup>6</sup> UNDP (2022) Strategjia Digjitale e UNDP-së 2022-2025 [https://digitalstrategy.undp.org/documents/Digital-Strategy-2022-2025-Full-Document\\_ENG\\_Interactive.pdf](https://digitalstrategy.undp.org/documents/Digital-Strategy-2022-2025-Full-Document_ENG_Interactive.pdf)

<sup>7</sup> Shih nenin 2 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (LIGJI NR. 06/L-081), i cili përjashton prodhimin, ndryshimin ose publikimin e përmbledhjeve të informatave kur një gjë e tillë do të përfshinte përpjekje joproportionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë.

## Monitorimi

- Të krijohen njësi statistikore në kuadër të ministrive të linjës;

## Infrastruktura

- Të investohet më shumë për softuer/baza të të dhënave institucionale për mbledhjen e të dhënave;
- Të përmirësohet ueb faqet publike ose të krijohet një sistem i centralizuar për menaxhim të dokumenteve për publikimin e të dhënave (si në Mal të Zi);
- të shtohen grupet punuese të ASK-së për të koordinuar punën me institucionet publike; dhe

## Të përmirësohet njohuritë për të dhënat

- Të ofrohen më shumë trajnime për vetëdijesimin për digjitalizimin.

# TË DHËNAT E HAPURA TË QEVERISË

Të Dhënat e Hapura të Qeverisë (DhHQ) janë një proces i administratës publike që inkurajon hapjen, llogaridhënien dhe shpërndarjen e informatave publike të qeverisë tek të gjithë qytetarët.<sup>8</sup> Thënë thjesht, të dhënat e hapura të qeverisë nënkuptojnë se informatat publike të qeverisë mund të raportohen, publikohen në kanale publike dhe kushdo mund të ketë qasje pa asnjë kufizim tek ato. Institucionet shtetërore prodhojnë dhe kërkojnë sasi masive të të dhënash dhe informatave. Këto institucione bëhen më të hapura dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve duke i bërë të disponueshme të dhënat e tyre. Qeveritë mund të inkurajojnë zhvillimin e bizneseve të reja dhe të shërbimeve të avancuara, me qytetarin në qendër, duke promovuar përdorimin, ripërdorimin dhe ndarjen falas të bashkësive të të dhënave. Nëpërmjet shpërndarjes online të të dhënave të hapura, disa vende kanë nisur nisma për transparencë për qeveritë dhe institucionet e tyre publike.

Portalet e hapura qeveritare zakonisht i menaxhojnë agjencitë qeveritare dhe, në disa raste, të dhënat ose nuk ofrohen në mënyrë adekuate ose jepen në mënyrë selektive. Për pasojë, u krijua një projekt ndërkombëtar i njohur si iniciativa e Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (PQH). PQH-ja duhej të drejtonte procesin e të Dhënave të Hapura të Qeverisë dhe të siguronte angazhime specifike nga qeveritë për të avancuar qeverisjen e hapur, për të fuqizuar qytetarët, për të luftuar korrupsionin dhe për të përdorur teknologji të reja për të forcuar qeverisjen. Krahasuar me anëtarët e BE-së, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kosova e filluan më vonë procesin e të dhënave të hapura dhe janë ende duke punuar për të përmirësuar cilësinë e të dhënave të ofruara. Edhe pse nuk është anëtare e PQH-së, Kosova është zotuar të respektojë parimet e PQH-së për të dhënat e hapura të qeverisë llogaridhënëse dhe i ka vazhduar me këmbëngulje përpjekjet e saja për të hyrë në sferën e qeverisjes digjitale.<sup>9</sup> Institucionet e Kosovës kanë zhvilluar disa iniciativa në kuadër të "Kartës Kombëtare për të Dhëna të Hapura", duke përfshirë portalin E-Kosova, platformat e konsultimit publik, digjitalizimin e shërbimeve publike, platformat për

<sup>8</sup> <https://www.oecd.org/gov/digital-government/open-government-data.htm>

<sup>9</sup> <https://ogpkosova.org/>

e-pjesëmarrje dhe mjetet e transparencës buxhetore. Publikimi i të dhënave në Kosovë është rritur gjatë pesë viteve të fundit, kryesisht për shkak të nxitjes nga shoqëria civile. Open Data Kosovo (ODK), një organizatë joqeveritare, ka punuar me Ministrinë e Administratës Publike të Kosovës për të krijuar ueb faqen e parë për të dhëna të hapura në Kosovë.<sup>10</sup> Open Data Kosovo ka zhvilluar një Indeks të Hapjes Rajonale si pjesë e projektit ACTION SEE të financuar nga BE-ja në partneritet me rrjetin rajonal të organizatave me të njëjtin emër.<sup>11</sup> Indeksi Rajonal i Hapjes vlerëson shkallën e hapjes institucionale në Ballkanin Perëndimor për qytetarët dhe shoqërinë sipas katër parimeve udhëzuese të mëposhtme: (1) transparenca, (2) qasshmëria, (3) integriteti dhe (4) vetëdijesimi. Sipas Indeksit të Hapjes Rajonale, të matur gjatë një periudhe prej katër viteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka marrë vlerësimin më të mirë (81.24%) në mesin e 46 institucioneve të ekzaminuara, ndërsa Komuna e Leposaviqit ka marrë vlerësimin më të ulët (0.00%); rezultati i Kosovës për shkallën e hapjes së të dhënave është 34.27%. Sipas këtij vlerësimi, Kosova renditet pas Serbisë dhe Malit të Zi, por qëndron përpara Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinës.

Sipas Open Data Kosovo, përkundër përpjekjeve për shpalesje të të gjitha të dhënave të disponueshme publikisht në Kosovë, ky proces është ende në fazat e hershme.<sup>12</sup> Nga organizata deklaruan se “do të jetë jetike të vendoset një kërkesë më e fortë ligjore për të ndihmuar në nxitjen pozitive të procesit të të dhënave të hapura dhe për të mbështetur përdorimin e të dhënave për të mirën publike. Në veçanti, duhet t’i kush-tohet vëmendje mënyrës se si do të sigurohet pajtueshmëria me rregullat për qeverisjen e të dhënave, të dhënat e hapura dhe ndarjen e të dhënave. Duke i parë më gjerësisht të dhënat për të mirën publike, duhen bërë përpjekje specifike për të rritur vetëdijesimin për të dhënat e prodhuara në sektorin privat dhe rëndësinë e përdorimit dhe hapjes së tyre për palët e interesit të sektorit publik dhe privat”.

Observatori i Agjendës Digjitale të Kosovës<sup>13</sup> identifikon disa çështje që duhen trajtuar: ndër këto, objektivat strategjikë të Agjendës Digjitale 2030 (e pa miratuar ende) duhet t’i japin rëndësi të madhe qeverisjes elektronike, veçanërisht digjitalizimit të shërbimeve publike; kurse shkathtësitë digjitale të zyrtarëve publikë duhet të rriten përmes trajnimeve të reja për TIK, në mënyrë që të zbatohet me sukses digjitalizimi i kërkuar nga strategjia.


<sup>10</sup> <https://opendataKosovo.org/>

<sup>11</sup> <https://opendataKosovo.org/portfolio/actionsee/>

<sup>12</sup> Në analizën e saj rajonale të DhHQ-së për Kosovën dhe Shqipërinë, në Barometrin Global të të Dhënave (2022). Raporti i Edicionit të Parë – Barometri Global i të Dhënave. ILDA. DOI: <https://doi.org/10.5281/zenodo.6488349>

<sup>13</sup> “Raporti për Vendin dhe Udhërrëfytyesi për zbatimin e Agjendës Digjitale në Kosovë, OBSERVATORI I AGJENDËS DIGJITALE të Kosovës 2022”. Qasur më 30 tetor 2022. <https://opendataKosovo.org/wp-content/uploads/2022/07/Kosovo-Country-Report-2022.pdf>





**GRAFIKU 1.** Indeksi Rajonal i Hapjes i vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Burimi: Open Data Kosovo

Kriteret për përdorimin e të dhënave të hapura në Kosovë janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-081.<sup>14</sup> Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, nga institucionet publike kërkohet që të publikojnë në mënyrë aktive çdo dokument publik që gjenerojnë, marrin, mbajnë ose kontrollojnë sapo të jetë i disponueshëm për publikim, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pasi të bëhet i qasshëm. Megjithatë, neni 2 thekson se institucioneve publike nuk u kërkohet të prodhojnë, modifikojnë ose publikojnë përmbledhje të informatave kur një gjë e tillë do të përfshinte përpjekje joproportionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë. Për shkak të kësaj, institucionet publike nuk mund të detyrohen të vazhdojnë të krijojnë dhe ruajnë një lloj të caktuar dokumenti publik për një akter të jashtëm ose një institucion tjetër publik për përdorim të mëvonshëm. Qasshmëria e të gjitha llojeve të të dhënave ndikohet potencialisht nga ky nen.

Prodhimi i të dhënave specifike, të tilla si statistika, informata ose raporte, mund të jetë i vështirë ose kërkon kohë. Shumë informata mund të fshihen nëse institucionet mendojnë se prodhimi i të dhënave është i vështirë. Për pasojë, ligji mund të kufizojë prodhimin e të dhënave të hapura dhe të pengojë përpjekjet për ta informuar siç duhet publikun. Nga ky ligj mund të rezultojë edhe sasia e kufizuar e informacionit të dhënë nga subjektet institucionale dhe deri diku mund të vihet në dyshim edhe cilësia e informacionit. Prandaj, nevojitet punë e mëtejshme për të ndryshuar qëllimin fillestar të ligjit për të siguruar qasje të plotë në të dhëna dhe për t'u kërkuar organizatave institucionale që të krijojnë informacion publik në mënyrë aktive, pavarësisht se sa sfidues mund të jetë apo sa kohë mund të marrë ky proces.

<sup>14</sup>[https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/LIGJI\\_NR.\\_06\\_L-081\\_P%C3%8BR\\_QASJE\\_N%C3%8B\\_DOKUMENTE\\_PUBLIKE-\\_shtator.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/LIGJI_NR._06_L-081_P%C3%8BR_QASJE_N%C3%8B_DOKUMENTE_PUBLIKE-_shtator.pdf)


# HARTËZIMI I TË DHËNAVE TË PRODHUARA NË INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE NË KOSOVË

Për hartëzimin e të dhënave që prodhohen në kuadër të institucioneve publike qendrore, u përdorën Treguesit Kyç të Performancës (TKP). TKP-të përdoren si mjete matëse që e shpjegojnë më mirë përdorimin e të dhënave nga institucionet publike qendrore të Kosovës pasi që numri i dokumenteve i referohet numrit të raporteve, dokumenteve strategjike apo të tjera të publikuara prej tyre. Në të njëjtën kohë, TKP-të tregojnë të dhënat aktuale të përdorura në kuadër të këtyre dokumenteve.

Shqyrtimi i ueb faqeve prodhoi 64 DOKUMENTE nga institucionet qendrore të Kosovës. Pas analizës së këtyre dokumenteve, janë mbledhur 261 SHËNIME TË TKP-VE dhe janë kategorizuar sipas institucionit botues dhe burimit (qoftë sipas llogaritjeve vetanake, marrë nga treguesit e ASK-së apo burime të tjera). TKP-të janë ndërlidhur me kategoritë e ASK-së nëse nuk ishin marrë nga ASK-ja. U ekzaminuan edhe 38 DOKUMENTE TË TJERA ME NJË NUMËR TË PËRGJITHSHËM PREJ 138 TKP-VE nga tri vendet e tjera, duke ndjekur të njëjtën qasje si në Kosovë (shih Aneksin 1).

Ky numër mundësoi një analizë domethënëse të cilësisë së të dhënave të prodhuara nga institucionet publike qendrore të Kosovës dhe një vlerësim të korrelacionit të tyre me të dhënat e prodhuara nga ASK-ja. Veç kësaj, u identifikuan hendekët e të dhënave dhe mungesa e të dhënave (p.sh. për sa i përket treguesve, llojit të të dhënave, mbulimit kohor).

Grafiku 1 paraqet dokumentet dhe TKP-të e ekzaminuara për secilin lloj institucioni qendror në Kosovë. Teksa numri i dokumenteve të ekzaminuara është i njëjtë për agjencitë dhe ministritë e linjës, numri i TKP-ve të përdorura në këto dokumente është dukshëm më i lartë në ministritë e linjës.



**GRAFIKU 1.** Numri i dokumenteve dhe TKP-ve të mbledhura për secilin lloj të institucionit publik qendror të Kosovës

Siç tregon Grafiku 2 më poshtë, pothuajse gjysma e institucioneve nuk kanë asnjë dokument të publikuar në ueb faqet e tyre. Gjithashtu ka pak dokumentacion nga agjencitë apo institucionet e tjera publike: përveç Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Vetëm 19 nga 40 institucione të ndërlidhura kanë të paktën një dokument të kohëve të fundit në ueb faqet e tyre, dhe vetëm tri kanë më shumë se dy dokumente të publikuara. (Shih Aneksin 1)


**KËSHTU, GJETJA E PARË E RËNDËSISHME ËSHTË NUMRI I ULËT I DOKUMENTEVE (D.M.TH. NJË MUNGESË E KONSIDERUESHME E TË DHËNAVE TË HAPURA) TË PUBLIKUARA NGA INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE.**

Numri i ulët i dokumenteve të mbledhura tregon mungesë të të dhënave të shkëmbyera nga institucionet qendrore; kjo u trajtua gjatë intervistave, duke theksuar disa faktorë që ndikojnë në këtë gjetje – ju lutemi shihni seksionin Gjetjet dhe Rekomandimet.

Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar më së shumti dokumente, me numër më të madh të TKP-ve. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ofron një numër të ulët të shënimeve në ueb faqe (4), por në shifra shumë të larta dhe rrjedhimisht edhe shkallë të lartë të TKP-ve (50; shih Tabelën 1). Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal tregojnë një numër të konsiderueshëm të dokumenteve të ndara (përkatësisht 5 dhe 4) me një numër mjaft të lartë të TKP-ve (15 dhe 21).

## HARTËZIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ZHVILLIM/

KAPACITETE TË ZGJERUARA INSTITUCIONALE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË KOSOVË



GRAFIKU 2. Dokumentet dhe TKP-të për secilën prej ministrive të linjës dhe agjencieve

**TABELA 1.** Numri i dokumenteve dhe TKP-ve për ministritë e linjës

Institucioni	Nr. i dokumenteve	Nr. i TKP-ve	Shkalla e TKP-ve
Ministria e Punëve të Brendshme	11	61	6
Ministria e Drejtësisë	5	15	3
Ministria e Financave	4	50	13
Ministria e Zhvillimit Rajonal	4	21	5
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	2	26	13
Ministria e Shëndetësisë	2	0	-
Ministria e Ekonomisë	1	0	-
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	0	-
Ministria e Mbrojtjes	1	0	-
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	0	0	-
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	0	0	-
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	0	0	-
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	0	0	-

\* Shkalla TKP-ve llogaritet si përpjesëtimi i numrit të dokumenteve ndaj numrit të TKP-ve

Tabela 2 paraqet numrin e dokumenteve të mbledhura sipas llojit të institucionit dhe llojit të dokumentit. Shumica dërrmuese e dokumenteve janë RAPORTE TË PËRGJITHSHME, VJETORE DHE STRATEGJIKE (përkatësisht 21, 9 dhe 22). Formati i të dhënave të hapura është përdorur në përgjithësi për buxhetet institucionale ose qëllime të tjera të të dhënave dhe, për rrjedhojë, këto nuk janë përdorur për këtë analizë.

**VLEN TË PËRMENDET SE JANË GJETUR VETËM KATËR RAPORTE STATISTIKORE (TË PREZANTUARA NGA KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT, DHE AVOKATURA SHTETËRORE), DHE PËRKUNDËR PRITJEVE JANË PARAQITUR NJË NUMËR I ULËT I TKP-VE.**

**TABELA 2.** Numri i dokumenteve dhe TKP-ve për lloj të institucionit dhe lloj të dokumentit

Etiketat e rreshtave	Ministritë e linjës		Agjencitë		Kuvendi		Gjithsej	
	Dokumente	TKP	Dokumente	TKP	Dokumente	TKP	Dokumente	TKP
Plani i veprimit	3	0	1	0			4	0
Raporti vjetor.	2	23	7	33			9	56
Koncept Dokument	1	4					1	4
Draft Raport	1	0					1	0
Formati për të dhëna të hapura			1	4			1	4
Raport i Përgjithshëm	10	79	10	25	1	4	21	108
Raport Statistikor	1	3	3	13			4	16
Raport Strategjik	13	64	8	10	1	0	22	74
Rubrika e ueb faqes			1	4			1	4
Gjithsej	<b>31</b>	<b>173</b>	<b>31</b>	<b>89</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>64</b>	<b>266</b>

Teksa disa TKP datojnë nga periudha 1999-2014, shumica e tyre tregojnë të dhëna të kohëve të fundit (kryesisht nga vitet 2020, 2021 dhe 2022) (shih Tabelën 3). Kjo është për shkak të praktikës së vlerësuesit për të mbledhur vetëm dokumente të kohëve të fundit.

**TABELA 3.** Viti / periudha e mbledhjes së TKP-ve

Viti/Periudha	Numri i TKP-ve
2010	1
2014	4
2015	9
2016	3
2019	23
2020	34
2021	61
2022	52
1999-2014	1
2000-2014	1
2007-2020	1
2012-2015	2

2015-2019	2
2015-2020	2
2016-2020	5
2018-2020	25
2018-2022	1
2019-2020	6
2019-2021	5
2020-2021	23
<b>Gjithsej</b>	<b>261</b>

Kur shqyrtohet Burimi i të Dhënave, mund të vërehet se shpeshtësia më e lartë lidhet me TKP-të me llogaritje vetanake nga institucioni kompetent (shih tabelën 4).

**166 RASTE MUND TË KONSIDEROHEN SI ME LLOGARITJE VETANAKE NGA  
INSTITUCIONI, NDËRSA NË 44 RASTE JANË PËRDORUR TREGUESIT E ASK-SË.**

Ky konstatim është i rëndësishëm kur krahasohet Kosova me juridiksionet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe në kontekstin e intervistave (shih më poshtë për analizën e detajuar). Kjo tregon mungesë të përdorimit të informatave të ASK-së nga institucionet publike qendrore. Ministrinë dhe agjencitë përdorin tregues të ASK-së në pothuajse 17% të TKP-ve të tyre. TKP-të e tjera me llogaritje vetanake rrjedhin nga institucionet e huaja si Banka Botërore, Eurostat, Transparency International dhe Komisioni Evropian, ndërsa disa prej tyre janë nga Banka Qendrore e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, etj. Numri i lartë i TKP-ve me llogaritje vetanake tregon potencialin për mbledhjen e të dhënave që kanë institucionet dhe përdorimin e ulët të të dhënave të ASK-së. Potenciali mund të shfrytëzohet duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet ASK-së dhe institucioneve të tjera qendrore për të inkorporuar më shumë tregues në strategjitë, raportet apo dokumentet e tyre.

**TABELA 4.** Numri i TKP-ve sipas burimit

	Agjencitë dhe Kuvendi	Ministritë e linjës	Gjithsej
KD	53	113	<b>166</b>
ASK	15	29	<b>44</b>
Institucione të tjera qendrore	10	11	<b>21</b>
Eurostat		7	<b>7</b>
Banka Qendrore e Kosovës	1	4	<b>5</b>
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	4		<b>4</b>
FMN		3	<b>3</b>
Korporata Energjetike e Kosovës	2		<b>2</b>
Institucione të tjera qendrore	2		<b>2</b>
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, Ministria e Punëve të Brendshme		1	<b>1</b>
Transparency International		1	<b>1</b>
Komisioni Evropian		1	<b>1</b>
Vlerësim i financuar nga BE-ja	1		<b>1</b>
Banka Botërore		1	<b>1</b>
Bota jonë në të dhëna		1	<b>1</b>
Raporti Vjetor Statistikor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës		1	<b>1</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>84</b>	<b>173</b>	<b>261</b>

**NUMRI I LARTË I TKP-VE ME LLOGARITJE VETANAKE TREGON NEVOJËN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE QENDRORE PËR MË SHUMË INFORMATA NGA ASK-JA. NË ANËN TJETËR, TREGUESIT NGA KËTO INSTITUCIONE MUND TË PËRFSHIHEN NË TË DHËNAT E ASK-SË.**

Në të vërtetë, shumë nga TKP-të e përdorura nga institucionet qendrore mund të kategorizohen sipas treguesve të ASK-së dhe të përdoren nga ASK-ja; në mënyrë alternative, mund të ishin përdorur të dhënat e ASK-së. Tabela 5 paraqet të gjithë treguesit të ndarë sipas kategorive të ASK-së (aty ku është e aplikueshme). Shumica e TKP-ve lidhen me kategoritë e popullatës, drejtësisë dhe arsimit, të lidhura me institucionet kryesore nga ku janë mbledhur dokumentet. Duke krahasuar TKP-të me llogaritje vetanake me ato që vijnë nga TKP-të e ASK-së (Tabela 6 dhe Tabela 5), mund të vërehet se ka një tendencë të qartë për t'i përdorur më shumë TKP-të me llogaritje vetanake për të njëjtat kategori.



**KJO TREGON SE SHUMË TREGUES QË HYJNË NË DOMENIN E ASK-SË DHE QË MATEN PREJ SAJ, JANË DUKE U VETË-LLOGARITUR NGA INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE.**

**TABELA 5.** Gjithsej TKP sipas kategorive të ASK-së

<b>Kategoritë e ASK-së</b>	<b>Agjencitë</b>	<b>Ministritë e linjës</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Të dhëna për fëmijët</b>	-	<b>7</b>	<b>7</b>
<b>Arsim</b>	<b>1</b>	<b>32</b>	<b>33</b>
<b>Energjetika</b>	<b>14</b>	-	<b>14</b>
<b>Mjedisi</b>	<b>4</b>	-	<b>4</b>
- Mjedisi	3	-	3
- Uji	1	-	1
<b>Shpenzime të ekzekutivit</b>	<b>1</b>	<b>11</b>	<b>12</b>
<b>Shëndetësi dhe mirëqenie</b>	-	<b>18</b>	<b>18</b>
<b>Të hyrat dhe kushtet e jetesës</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>8</b>
- Shëndetësi dhe mirëqenie	-	1	1
- Të hyrat dhe kushtet e jetesës	-	1	1
- Të hyrat për amvisëri	1	1	2
- Treguesit e Policisë	4	-	4
<b>Drejtësia</b>	<b>24</b>	<b>11</b>	<b>35</b>
- Gjykatat	24	1	25
- Drejtësia penale	-	10	10
<b>Tregu i punës</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<b>Llogaritë vendore dhe institucionale</b>	<b>4</b>		<b>4</b>
<b>Popullata</b>	<b>4</b>	<b>61</b>	<b>65</b>
- Migrimi		51	51
- Popullata	4	10	14
<b>Statistika afatshkurtra</b>	-	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>Regjistri Statistikor i Bizneseve</b>	<b>7</b>	-	<b>7</b>
<b>Statistikat strukturore të biznesit</b>	<b>2</b>	-	<b>2</b>
<b>UNDP, Puls i Publik</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>7</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>71</b>	<b>151</b>	<b>222</b>

**TABELA 6.** TKP të vetë-zgjedhura sipas Kategorive të ASK-së

Kategoritë e ASK-së	Agjencitë	Ministritë e linjës	Gjithsej
<b>Të dhëna për fëmijët</b>	-	<b>7</b>	<b>7</b>
<b>Arsim</b>	<b>1</b>	<b>25</b>	<b>26</b>
<b>Mjedisi</b>	<b>1</b>	-	<b>1</b>
- Uji	1	-	1
<b>Shpenzime të ekzekutivit</b>	-	<b>7</b>	<b>7</b>
<b>Shëndetësi dhe mirëqenie</b>	-	<b>18</b>	<b>18</b>
<b>Të hyrat dhe kushtet e jetesës</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
- Të hyrat për amvisëri	-	1	1
- Treguesit e Policisë	4	-	4
<b>Drejtësia</b>	<b>24</b>	<b>10</b>	<b>34</b>
- Gjykatat	24	1	25
- Drejtësia penale	-	9	9
<b>Tregu i punës</b>	-	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>Popullata</b>	-	<b>24</b>	<b>24</b>
- Migrimi	-	24	24
<b>Regjistri Statistikor i Bizneseve</b>	<b>7</b>	-	<b>7</b>
<b>UNDP, Pulsi Publik</b>	-	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>95</b>	<b>132</b>

Tabela 7 tregon numrin e TKP-ve që do të mund të ishin përdorur nga kategori të ndryshme të ASK-së nëse do të adresoheshin siç duhet për secilin institucion, ose të cilat do të mund të integroheshin në kuadër të treguesve të ASK-së.

Disa nga këta tregues janë shumë specifike dhe mund të mos konsiderohen mjaft të rëndësishëm për t'u përfshirë në listën e treguesve të ASK-së. Por, siç thekson analiza cilësore, ndër arsytet janë mungesa e detyrimit ligjor për t'ia komunikuar të dhënat ASK-së dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe ekspertizës për të siguruar cilësinë e të dhënave.

**PËR SHEMBULL, KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, SË BASHKU ME MINISTRINË E DREJTËSISË, MINISTRINË E ZHVILLIMIT RAJONAL DHE AVOKATURËN SHTETËRORE KANË SHUMË INFORMATA PËR GJYKATAT, TË CILAT MUND TË BIEN NËN KATEGORINË E DREJTËSISË. KËTO TË DHËNA MUND TË KOORDINOHEN ME ASK-NË PËR T'I PASURUAR TREGUESIT AKTUALË.**

**TABELA 7.** Institucioni / Kategoria e ASK-së për TKP-të e vetë-përzgjedhura

<b>INSTITUCIONI / KATEGORIA E ASK-së</b>	<b>TKP</b>
<b>Agjencia e Menaxhimit Emergjent</b>	<b>2</b>
- <b>Arsim</b>	<b>1</b>
- <b>Mjedisi</b>	<b>1</b>
• Uji	1
<b>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës - ARBK</b>	<b>7</b>
- <b>Regjistri Statistikor i Bizneseve</b>	<b>7</b>
<b>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</b>	<b>16</b>
- <b>Drejtësia</b>	<b>16</b>
• Gjykatat	16
<b>Policia e Kosovës</b>	<b>4</b>
- <b>Drejtësia</b>	<b>4</b>
• Treguesit e Policisë	4
<b>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</b>	<b>26</b>
- <b>Arsim</b>	<b>25</b>
- <b>Të hyrat dhe kushtet e jetesës</b>	<b>1</b>
• Të hyrat për amvisëri	1
<b>Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve</b>	<b>31</b>
- <b>Të dhëna për fëmijët</b>	<b>7</b>
- <b>Shpenzime të ekzekutivit sipas COFOG</b>	<b>6</b>
- <b>Shëndetësi dhe mirëqenie</b>	<b>18</b>
<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>	<b>24</b>
- <b>Popullata</b>	<b>24</b>
• Migrimi	24
<b>Ministria e Drejtësisë</b>	<b>12</b>
- <b>Shpenzime të ekzekutivit sipas COFOG</b>	<b>1</b>
- <b>Drejtësia</b>	<b>10</b>
• Gjykatat	1
• Drejtësia penale	9
- <b>Indeksi Demokratik dhe Ekonomik i UNDP-së</b>	<b>1</b>
<b>Ministria e Zhvillimit Rajonal</b>	<b>2</b>
- <b>Tregu i punës</b>	<b>2</b>
- <b>Këshilli Prokurorial</b>	<b>5</b>
- <b>Drejtësia</b>	<b>5</b>
• Gjykatat	5
<b>Avokatura Shtetërore e Kosovës</b>	<b>3</b>
- <b>Drejtësia</b>	<b>3</b>
• Gjykatat	3
<b>Gjithsej</b>	<b>132</b>

## ANALIZË KRAHASUESE ME TRI VENDE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Për krahasim u zgjodhën Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Të dhënat e tyre janë përfshirë në Aneksin 2, Aneksin 4 dhe Aneksin 6. U zgjodhën tri ministri, marrë parasysh numrin e madh të dokumenteve dhe TKP-ve nga analiza e institucioneve të Kosovës: Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Si vërejtje e përgjithshme (shih tabelën 8):

**KOSOVA TREGON NJË NUMËR MË TË MADH TË DOKUMENTEVE DHE TKP-VE TË MBLEDHURA PËR KËTO TRI MINISTRI TË LINJËS. INSTITUCIONET E SHQIPËRISË TREGUAN NJË NUMËR TË LARTË DOKUMENTESH ONLINE, POR PËRDOREN VETËM DISA TREGUES. MALI I ZI DHE MAQEDONIA E VERIUT KANË NUMËR TË NGJASHËM TË DOKUMENTEVE DHE TKP-VE.**

**TABELA 8.** Numri i dokumenteve dhe TKP-ve për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut krahasuar me Kosovën për tri ministritë e linjës

	Shqipëri		Mali i Zi		Maqedoni e Veriut		Kosovë		Gjithsej	
	Dokumente Nr.	Nr. i TKP-ve	Dokumente Nr.	Nr. i TKP-ve	Dokumente Nr.	Nr. i TKP-ve	Dokumente Nr.	Nr. i TKP-ve	Dokumente Nr.	Nr. i TKP-ve
<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>	4	22	3	39	2	40	4	50	13	151
<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	0	0	1	7	5	13	2	0	8	20
<b>Ministria e Drejtësisë</b>	3	0	5	11	6	5	5	15	16	31
<b>Gjithsej</b>	<b>4</b>	<b>22</b>	<b>9</b>	<b>57</b>	<b>13</b>	<b>58</b>	<b>11</b>	<b>65</b>	<b>37</b>	<b>202</b>

Ngjashëm me Kosovën, tri vendet e tjera kanë numër më të madh të dokumenteve që bien në kategorinë për Raporte (shih Tabelën 9). Si përjashtim, Maqedonia e Veriut ka një dokument me format të hapur me 40 tregues, ndërsa Mali i Zi ka një dokument të politikave me 23 TKP.

Formatet e të dhënave të hapura mungojnë ose janë shumë të rralla në të gjitha vendet dhe në Kosovë. Mungesa e informacionit që mund të analizohet më tej nga persona të jashtëm mund të jetë për shkak të mungesës së presionit publik për të dhëna mikro, ose pamundësisë së institucioneve publike për t'i siguruar ato, ose mungesës së gatishmërisë për t'i shpalosur.

**TABELA 9.** Dokumentet dhe TKP-të sipas llojit të dokumentit

Llojet e dokumenteve	Shqipëri		Mali i Zi		Maqedoni e Veriut		Kosovë		Gjithsej	
	TKP	Dokumente	TKP	Dokumente	TKP	Dokumente	TKP	Dokumente	TKP	Dokumente
Plani i veprimtimit	0	2	0	1	0	1	0	2	0	6
Raporti vjetor.	0	1							0	1
Koncept Dokument							4	1	4	1
Formati për të dhëna të hapura					40	1			40	1
Politika			23	1					23	1
Raport	0	2	3	3	0	3	58	6	61	14
Raport Statistikor	0	1							0	1
Raport Strategjik	22	3	31	4	18	8	3	2	74	17
<b>Gjithsej</b>	<b>22</b>	<b>9</b>	<b>57</b>	<b>9</b>	<b>58</b>	<b>13</b>	<b>65</b>	<b>11</b>	<b>202</b>	<b>42</b>

Tabela 10 paraqet TKP-të sipas institucionit dhe burimit për çdo vend të BP-së. Vlen të theksohet se Ministria e Financave e Maqedonisë së Veriut përdor 40 TKP nga Zyra Kombëtare e Statistikave, ndërsa Shqipëria ka vetëm 9 dhe Kosova 4. Edhe Ministria e Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut ka një TKP nga Qendra Statistike, ndërsa vendet e tjera të BP-së nuk listojnë më shumë TPK nga qendrat e tyre statistikore.

Ky konstatim është interesant, marrë parasysh numrin e lartë të TKP-ve që kanë përdorur institucionet e Kosovës, krahasuar me Maqedoninë e Veriut, e cila ka më pak të dhëna, por kryesisht mbështetet në Agjencinë Kombëtare të Statistikave.

**VEÇ KËSAJ, MUND TË VËREHET SE KOSOVA KA MË SHUMË TREGUES ME LLOGARITJE VETANAKE SE VENDET E TJERA, TË CILAT ZAKONISHT KANË BURIME TË DEFINUARA MIRË PËR TKP-TË E TYRE.**

**TABELA 10.** Krahasimi i vendeve (dhe Kosovës) sipas numrit të TKP-ve për institucionin dhe burimin

Institucioni / Burimi	Shqipëri	Mali i Zi	Maqedoni e Veriut	Kosovë	Gjithsej
<b>Ministria e Financave</b>	<b>22</b>	<b>39</b>	<b>40</b>	<b>48</b>	<b>149</b>
Banka e Shqipërisë	6				6
Instituti i Sipërmarrjes dhe Zhvillimit		1			1
Komisioni Evropian				1	1
Eurostat				1	1
GII		1			1
FMN				3	3
MONSTAT		15			15
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)	9		40	4	53
Institucione të tjera qendrore		16			16
Bota jonë në të dhëna				1	1
<b>Llogaritje vetanake</b>	<b>7</b>			<b>37</b>	<b>44</b>
UNSTAT		1			1
VCPE		1			1
Banka Botërore				1	1
Të Bërit Biznes nga Banka Botërore		1			1
Logjistika Tregtare nga Banka Botërore		1			1
Forumi Ekonomik Botëror		2			2
<b>Ministria e Shëndetësisë</b>		<b>7</b>	<b>13</b>		<b>20</b>
Komisioni Evropian			1		1
OECD			1		1
Institucione të tjera qendrore			6		6
<b>Llogaritje vetanake</b>		<b>7</b>			<b>7</b>
Agjencia e Statistikave të Kosovës			1		1
UNICEF			1		1
Perspektivat e Popullsisë Botërore nga Kombet të Bashkuara			1		1
Banka Botërore			2		2
<b>Ministria e Drejtësisë</b>		<b>11</b>	<b>5</b>	<b>15</b>	<b>31</b>
ASK, Përmbledhja e Pulsit Publik XVIII për Kosovën				1	1
Institucione të tjera qendrore		5		1	6
Burime të tjera		2			2
<b>Llogaritje vetanake</b>		<b>4</b>	<b>5</b>	<b>11</b>	<b>20</b>
IML				1	1
Transparency International				1	1
<b>Gjithsej</b>	<b>22</b>	<b>57</b>	<b>58</b>	<b>63</b>	<b>200</b>

Si përfundim, mund të theksohet se Kosova demonstroi përdorim të mirë të TKP-ve në dokumentet e kontrolluara. Megjithatë, përdorimi është i kufizuar në raporte. Në Mal të Zi, u gjet një dokument i politikave me 23 TKP në përdorim. Kjo tregon një tendencë për t'i bazuar në të dhëna politikat publike. Ndonëse nuk mund të përgjithësohet, duket se Kosova, si dy vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, tregon përdorim më të madh të TKP-ve në raportim sesa për mbështetjen e politikave.

Të dhënat e hapura nuk janë përdorur vetëm në Maqedoninë e Veriut. Përdorimi dhe publikimi i të dhënave të hapura nga Maqedonia e Veriut lidhet me mbështetjen më të madhe në të dhënat e Zyrës Kombëtare të Statistikave, gjë që siguron edhe formatin e hapur. Kjo konfirmon përfitimin e përdorimit të të dhënave të ASK-së, jo vetëm për shkak të besueshmërisë së të dhënave, por edhe për shkak të formatit më të mirë që ofron.

Një gjetje tjetër e rëndësishme lidhet me burimin e TKP-ve të përdorura në dokumente. Kosova ka 48 TKP nga burimet me llogaritje vetanake (që përbëjnë pothuajse 75% të gjithsej TKP-ve). Shqipëria ka 7 (rreth 30% e gjithsej burimeve të përdorura), dhe Mali i Zi 11 (20% e gjithsej burimeve të përdorura). Nga ana tjetër, Maqedonia e Veriut nuk shfaq përdorim të TKP-ve me llogaritje vetanake. Fakti tjetër interesant ka të bëjë me përdorimin e të dhënave nga zyrat statistikore. Maqedonia e Veriut ka 41 TKP nga zyra e saj kombëtare e statistikave, që përbëjnë pothuajse 71% të burimeve të saj. Kosova në anën tjetër ka vetëm 5 TKP (rreth 7% e gjithsej TKP-ve), çka konfirmon një përdorim mjaft të ulët të të dhënave të ASK-së.

# ANALIZA E SHKAQEVE TË PËRDORIMIT TË PAKËT TË TË DHËNAVE DHE SISTEMEVE PËR NDARJE TË TË DHËNAVE, DHE QASJET E REKOMANDUARA PËR TA PËRMIRËSUAR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE

Kjo pjesë e analizës synon:

- Të vlerësojë shkaqet e përdorimit të pakët të të dhënave në politikëbërje;
- Të analizojë sistemet ekzistuese për ndarje të të dhënave dhe të japë rekomandime për sistemet apo mekanizmat e mundshëm për të lehtësuar ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve publike qendrore dhe ASK-së, dhe;
- Të japë rekomandime për qasjet për të përmirësuar mbledhjen, digjitalizimin, ndarjen dhe përdorimin e të dhënave për politikëbërje në mbarë institucionet publike qendrore të Kosovës.

Për të adresuar pikat e mësipërme, në korrik 2022 u zhvilluan njëmbëdhjetë intervista me sekretarë të përgjithshëm të ministrive të linjës, drejtorë të agjencive publike dhe kontakte personale. Intervistat ofruan një analizë të thelluar të shkaqeve të përdorimit të pakët të të dhënave në politikëbërje, duke siguruar të kuptuarit e proceseve për ndarje të të dhënave dhe si të përmirësohet mbledhja, digjitalizimi dhe mbështetja e të dhënave për politikëbërjen.

- U realizuan 11 intervista me 17 persona: sy më sy dhe 5 online
- U realizua edhe një intervistë sy më sy me drejtorin e ASK-së
- 2 intervista të tjera u anuluan për shkak të problemeve shëndetësore të të intervistuarve
- Intervistat shkuan nga 30 deri në 60 minuta

Intervistat theksuan çështje të ndryshme në lidhje me përdorimin e të dhënave në kuadër të institucioneve publike qendrore të Kosovës. Teksa mund të vërehen tema specifike që lidhen me historikun e secilit institucion, disa tipare të përbashkëta theksojnë nevojën për përdorim më të mirë të të dhënave digjitale dhe bashkëpunimin me ASK-në.

Gjetjet kryesore janë si më poshtë. (Shih Tabelën 12 për disa shqetësime kyçe nga secila intervistë.)



## ANALIZA TEMATIKE DHE GJETJET

Ky seksion tregon disa nga gjetjet kryesore nga intervistat. Ato theksojnë disa sfida me të cilat përballen institucionet publike në përballjen me problemet e mbledhjes, transformimit, analizës dhe publikimit të të dhënave (në format të dhënash të hapura agregate ose mikro), të cilat mund të grupohen sipas dy temave kryesore: (1) sfidat me kapacitetet dhe resurset dhe (2) sfidat me integritetin e të dhënave. Të dyja janë të ndërlidhura, pasi që mungesa e burimeve njerëzore dhe resurseve të tjera për t'u marrë me mbledhjen, ruajtjen dhe analizën e të dhënave, ndikon në integritetin e të dhënave në të gjitha këto hapa – dhe për pasojë minon integritetin e të dhënave.

### 1. Sfidat me kapacitetet dhe resurset:

#### 1.1. vetëdijesimi për nevojën e digjitalizimit

Intervistat tregojnë se të gjithë akterët janë të vetëdijshëm për nevojën e digjitalizimit në institucionet e tyre. Ata pranojnë se digjitalizimi do t'u sjellë dobi në kryerjen më të mirë të detyrave të tyre. Siç tha një nga të intervistuarit: *"Ne e kuptojmë se në këtë shekull të dhënat duhet të jenë online dhe po përpiqemi të përballemi me këtë."* Megjithatë, është i limituar vetëdijesimi për ndikimin që do të kishte tek publiku digjitalizimi në institucionin e tyre në lidhje me qasjen në të dhëna (mundësisht në format të hapur) dhe transparencën. Kjo duhet të adresohet përmes ngritjes së kapaciteteve dhe vetëdijesimit për rëndësinë e digjitalizimit në kuadër të institucioneve publike qendrore.

#### 1.2. Nevoja për të dhëna për vendimmarrje: mungesa e resurseve

Puna me të dhëna është sfiduese për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare të disponueshme:

- Pothuajse asnjë nga institucionet e intervistuar nuk kishte ZYRË për statistika. Përrjashtim bënë Shërbimi Sprovues i Kosovës, Këshilli Prokurorial dhe Zyra Gjyqësore. Intervistat theksuan riskun për integritetin e të dhënave nga mungesa e softuerit për menaxhim të rasteve dhe nga gabimet njerëzore gjatë futjes së të dhënave.
- Institucionet pa zyrë statistikore mbështeten NË BURIME TË BRENDSHME PA KUALIFIKIME PËR MENAXHIMIN E TË DHËNAVE.

#### 1.3. Bashkëpunimi me ASK-në në shumë raste është minimal

Përkundër nevojës në rritje për vendimmarrje të bazuar në të dhëna, analiza e burimeve të TKP-ve tregoi se shumica e institucioneve nuk i përdorin TË DHËNAT E ASK-SË. Në të vërtetë, kishte vetëm 44 raste të ASK-së në mesin e 261 TKP-ve të hartëzuara – 17% e totalit. Kjo ishte për shkak të disa faktorëve:

- Të intervistuarit vunë në pah se treguesit janë të veçantë për veprimtarinë e institucioneve të tyre, prandaj institucionet nuk mund t'i përdorin të dhënat e ASK-së për nevojat e tyre. Kjo megjithatë krijon një mundësi që institucionet qendrore t'i ndajnë të dhënat e tyre me ASK-në. Megjithatë, kjo nuk bëhet aktualisht.
- Stafi i limituar me trajnim adekuat për menaxhimin e të dhënave rezulton në mungesë të qasjes, të kuptuarit apo shkëmbimit me të dhënat online të ASK-së, dhe kështu humbet një mundësi për të mbledhur të dhëna origjinale institucionale dhe për të krijuar një sistem për shkëmbim me ASK-në. Kërkohe më shumë trajnime për ta ulur këtë pengesë.

#### **1.4. Mungesa e softuerit për mbledhjen e të dhënave**

Një temë e përbashkët për shumicën e intervistave ishte se menaxhimi i të dhënave pengohet nga mungesa e softuerit për të regjistruar, manipuluar dhe krijuar raportim automatik mbi të dhënat. Teksa disa nga institucionet përmendën iniciativa dhe financime të ndryshme nga Ekzekutivi apo donatorë të tjerë, aktualisht të gjitha zyrat përdorin Excel-in si aplikacion primar për menaxhimin e të dhënave. Përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë përmendën paketën SMIL (Synchronized Multimedia Integration Language), e cila ende është duke u zhvilluar si një mjet për menaxhimin e lëndëve për të gjitha proceset që përfshijnë policinë, prokurorët, gjyqtarët, shërbimet sprovuese etj. Aplikacionet e tjera nuk janë zbatuar plotësisht për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ose për shkak se ato nuk u zhvilluan kurrë plotësisht (p.sh. paraardhësi i SMIL, një mjet për menaxhimin e rasteve i financuar nga BE-ja): Kjo tregon se:

- Mbledhja e të dhënave kërkon punë intensive;
- Disa statistika nuk janë të besueshme për shkak të metodologjive të ndryshme të përdorura;
- Menaxhimi i rasteve është i ndërlikuar për t'u bërë me Excel.

Pa një sistem të duhur për menaxhim të të dhënave, është e vështirë t'u kërkohe institucioneve të sigurojnë integritetin e informacionit. Mungesa e softuerit dhe proceseve të përshtatshme për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave e pengon aftësinë e institucioneve për ta digjitalizuar punën e tyre.

#### **1.5. Mungesa e një ueb faqeje institucionale**

Një kërkesë e përbashkët e mbështetur për zhvillimin e një ueb faqeje dinamike ku institucioni në fjalë mund të publikojë të dhënat e tij dhe të rrisë angazhimin me publikun. Teksa mungesa e një ueb faqeje është veçanërisht e dukshme për agjencitë, ministritë e linjës vunë në pah përditësimet e përsëritura të ueb faqes kryesore me humbje të dokumenteve të publikuara që nuk mund të riktheheshin ose të gjendeshin lehtësisht. Në Mal të Zi, përkundrazi, portali *gov.me* ofron një mënyrë shumë fleksibël dhe të lehtë për të gjetur dokumente nëpër institucione të ndryshme qendrore, duke ruajtur historikun e dokumenteve.

#### **1.6. Mungesa e obligimit për shkëmbimin e të dhënave me ASK-në apo publikimin e informatave**

Disa të intervistuar vunë në dukje se institucionet do të ndiheshin të obliguara të publikojnë dhe ndajnë të dhëna me ASK-në dhe publikun e gjerë nëse kjo do të ishte një kërkesë ligjore. Aktualisht, mungesa e obligimit ligjor rezulton në mungesë të nxitjes reale për ndarjen e të dhënave.

### 1.7. Mungon infrastruktura për ruajtjen e të dhënave

Të dhënat përgjithësisht mbahen në kompjuterë personale pasi ka mungesë të serverëve dhe të çdo lloji të infrastrukturës së bazës së të dhënave për t'i të dhënat ruajtur në mënyrë të sigurt. Grupet e të dhënave përpunohen individualisht, dhe në të gjitha rastet, Excel është aplikacioni kryesor që përdoret për ruajtjen e të dhënave.

## 2. Sfidat me integritetin e të dhënave

### 2.1. Nuk ka metodologji për mbledhjen e të dhënave

Teksa pothuajse të gjitha institucionet kanë krijuar mënyra specifike për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, u ngritën shqetësime për integritetin e të dhënave për shkak të mungesës së përgjithshme të Procedurave Standarde të Operimit për mënyrën si funksionon procesi i mbledhjes së të dhënave, si sigurohet integriteti i të dhënave dhe kush është përgjegjës për procesin. Kjo u theksua veçanërisht në një intervistë, duke vënë në dukje probleme jo vetëm gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, por edhe gjatë fazës së analizës së të dhënave: *“na duhet të shqetësohemi jo vetëm për mënyrën si i mbledhim të dhënat prej tyre [institucionet e tjera], por edhe nëse arrijmë në rezultate të ndryshme, pasi që metodologjitë tona ndryshojnë dhe ne publikojmë të njëjtat rezultate me shifra të ndryshme.”*

### 2.2. Të dhënat e papublikuara

Shumë të intervistuar theksuan se shumë nga të dhënat e mbledhura për përdorim të brendshëm nuk publikohen në ueb faqen përkatëse. Kjo krijon një mundësi të shkëlqyer për përmirësimin e transparencës së të dhënave me pak përpjekje, pasi që të dhënat veç janë aty.

## REKOMANDIME

### Korniza ligjore

- **Rekomandohet forcimi i kërkesave ligjore për shkëmbimin e të dhënave.** Përveç mungesës së resurseve (financiare dhe njerëzore, që rezulton në mungesë të zyrave statistikore me kualifikime specifike për menaxhimin e të dhënave), mungesës së të dhënave të hapura dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve qendrore (që e pengojnë aftësinë e institucioneve publike të Kosovës për të mbledhur të dhëna), pengesë për investimet për menaxhimin e të dhënave ose specializimin e burimeve njerëzore për këtë detyrë, krijon edhe mungesa e kornizës ligjore gjithëpërfshirës që do ta shtynte përpara procesin e të dhënave të hapura. **Rekomandohet** rishikimi i këtij ligji në mënyrë që institucionet të mos kenë mundësi të mbrohen me arsye të dobëta apo të sajuara nga prodhimi i të dhënave për tema të veçanta. Hulumtimi i realizuar ka identifikuar nevojën për nxitjen e të dhënave të hapura dhe proceseve për shkëmbim të të dhënave ndërmjet institucioneve dhe me publikun. Andaj, nëse qëllimi është të sigurohet transparencë e plotë dhe të ndihmohen institucionet t'i ndajnë dhe publikojnë të dhënat e tyre, si dhe të adresojnë kërkesat e individëve që mund ta kërkojnë atë informacion specifik, ndryshim i këtij ligji duket i nevojshëm. Për të garantuar saktësinë e të dhënave të paraqitura, edhe subjektet institucionale duhet të jenë të detyruara të mbështeten në të.
- **Rekomandohet rishikimi i ligjit për qasje në dokumente publike.** Institucionet publike janë të përjashtuara me ligj<sup>15</sup> nga prodhimi, ndryshimi ose publikimi i përmbledhjeve të informatave kur një gjë e tillë do të përfshinte përpjekje joproporcionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë. **Rekomandohet** rishikimi i këtij ligji, sepse kjo ua mundëson institucioneve të mbrohen me arsye të dobëta apo të sajuara nga prodhimi i të dhënave për tema të veçanta. Nëse qëllimi është të sigurohet transparencë e plotë dhe të ndihmohen individët që mund ta kërkojnë atë informacion specifik, ndryshim i këtij ligji duket i nevojshëm. Për të garantuar saktësinë e të dhënave të paraqitura, edhe subjektet institucionale duhet të jenë të detyruara të mbështeten në të.

### Infrastruktura

- **Rekomandohet përmirësimi i bazave të të dhënave institucionale.** Asnjë softuer qendror për menaxhimin e të dhënave nuk përdoret nga institucionet publike të intervistuar. Kjo nxjerr në pah nevojën për të përmirësuar investimet në një drejtim të tillë që të rrisë asetet për të lehtësuar mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave. **Rekomandohet** të investohet më shumë në softuer specifik (si p.sh. SMIL në gjyqësor) i cili bashkon të dhënat e mbledhura nga zyra dhe institucione të ndryshme. Kjo do të nxiste mbledhjen e të dhënave, por edhe do të përmirësonte cilësinë e të dhënave dhe besueshmërinë e tyre për politikën publike.
- **Rekomandohet përmirësimi i ueb faqeve institucionale.** Në disa raste kur të dhënat ishin mbledhur në mënyrë eksplicite nga institucionet, u vu re se disa agjencive u mungonin resurset për të krijuar një ueb faqe institucionale dhe për t'i ndarë publikisht të dhënat e tyre. **Rekomandohet** futja e Sistemeve për Menaxhim të Përmbajtjes në nivelin ndër-institucional që mund të aktivizohen, përdoren dhe per-

<sup>15</sup>Neni 2 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (LIGJI NR. 06/L-081)

sonalizohen nga përdoruesit fundorë në çdo institucion. Kjo do të ishte me kosto efektive për sa i përket hosting-ut, konfigurimit dhe menaxhimit të ueb faqes.

- **Rekomandohet krijimi i një sistemi të centralizuar për menaxhim të dokumenteve** Intervistat theksuan çështjet e integritetit të të dhënave që lindin nga mungesa e softuerit për menaxhim të rasteve ose gabimet njerëzore gjatë futjes së të dhënave. Për ta adresuar këtë janë ndërmarrë iniciativa të ndryshme, por asnjëherë nuk janë zbatuar plotësisht. Nevojitet hardueri i duhur (serverët; sistemet rezervë) dhe softueri (softuer specifik për mbledhjen e të dhënave; sistemet e menaxhimit të dokumenteve; ueb faqet publike). Teksa shkëmbimi i të dhënave ndërmjet ASK-së dhe institucioneve të tjera publike është një proces që mund të kërkojë kohë dhe resurse, megjithatë disa masa do të nxisnin dhe lehtësonin publikimin e të dhënave. Ky proces duhet të mbështesë forcimin e kërkesave ligjore (rekomandimi i parë), siç është pohuar në këtë raport.

Shembulli i Malit të Zi tregon se sistemi i centralizuar për menaxhim të dokumenteve ua mundëson institucioneve t'i publikojnë të dhënat e tyre në formate të ndryshme (madje edhe të dhëna të hapura) dhe madje do të të ruanin dokumente të kaluara (të cilat nuk janë publikuar për shkak të ndryshimeve në ueb faqe nga administratat e mëparshme. Kështu, Kosova do të mund të përfitonte nga një sistem i tillë.

### Sistemi i monitorimit

- **Rekomandohet krijimi i njësive qendrore statistikore në nivel të ministrive të linjës.** Pothuajse të gjitha institucionet e përfaqësuara në intervista nuk kishin asnjë zyrë/njësi statistikore apo edhe staf me formimin dhe përvojën e duhur, gjë që rrjedhimisht ndikon në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Shumica e të intervistuarve theksuan se, për shkak të kësaj, ata nuk kanë të dhëna – ose nëse kanë, vërejnë mospërputhje me institucionet e tjera që mbledhin të njëjtat të dhëna. Kjo çon në keqinterpretim të këtyre të dhënave për politikëbërjen publike. Një njësi qendrore statistikore do të kishte një ndikim të fuqishëm në krijimin e metodologjive të shëndosha për mbledhjen e të dhënave dhe përmirësimin e shkëmbimit të të dhënave me ASK-në. Resurset e dedikuara do të rrisnin efektshmërinë dhe besueshmërinë e mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe, për rrjedhojë, besueshmërinë e informacionit për politikën publike. Krijimi i njësive qendrore statistikore do të duhej të mbështetej nga obligimi ligjor i identifikuar dhe shprehur në rekomandimin e parë.
- **Rekomandohet të shtohet vlerësimi ex-post i ndikimit për politikën publike.** Vlerësimi i Ndikimit Rregullativ kërkohet për rregulloret e reja në Kosovë.<sup>16</sup> Shtimi i përdorimit të tij në vlerësime ex-ante dhe ex-post do të krijonte më shumë kërkesë për të dhëna dhe do të rriste presionin për të adoptuar masa për të përmirësuar mbledhjen dhe ndarjen e të dhënave.

### Njerëzit: njohuritë digjitale

- **Rekomandohet të shtohen grupet punuese të ASK-së me institucione të tjera publike.** Siç vuri në dukje intervista e ASK-së, ka precedentë për grupet punuese të ASK-së me institucionet publike – edhe pse kryesisht me ministrinë e linjës që kontribuojnë në mënyrë aktive në menaxhimin e të dhënave. **Rekomandohet edhe** përfshirja e më shumë institucioneve në grupe të tilla punuese dhe fillimi i aktiviteteve më gjithëpërfshirëse, si p.sh.
  - klasa/punëtori për trajnime të përgjithshme për menaxhimin e të dhënave;
  - grupet ndërministrorë për të shkëmbyer ide dhe për të identifikuar të dhënat që mund të ndahen.

<sup>16</sup> Shih Radulović, B., & Alimehmeti, G. (2018). Rregullim më i mirë në Ballkanin Perëndimor. ReSPA. <https://www.respaweb.eu/download/doc/Better+Regulation+in+Western+Balkans.pdf/b36b9eaa7978cd29b59d248b85e31cc5.pdf>

Kjo do të kishte më shumë ndikim në administratën e përgjithshme, dhe kështu do të rriste kapacitetin e stafit për t'i kuptuar të dhënat e ASK-së dhe përdorimin e tyre në kuadër të proceseve. Gjithashtu do të krijonte mundësi për të krijuar aranzhime me ASK-në për të mbledhur të dhëna specifike.

	SYSTEM	APPROACHES
<b>Legal Framework</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Improvement of the Legal requirement for Data Exchange</li> <li>• Revision of the Law on Access to Public Documents</li> </ul>	NA
<b>Monitoring Infrastructure</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Improvement of Institutional Databases</li> <li>• Creation of Data Management System</li> <li>• Improve the Institutional Websites</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Creation of central statistical units at the Line Ministries Level</li> <li>• Increase of the Ex-Post Impact Assessment for Public Policy</li> </ul>
<b>Infrastructure</b>	NA	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Centralized Document Management System</li> <li>• Publish data in Open format, Historical Data</li> </ul>
<b>People: Digital Literacy</b>	NA	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Increase of KAS working groups with other public institutions</li> <li>• Personnel Training, Working Groups</li> </ul>

**FIGURA 1.** Rekomandime

## METODOLOGJIA

Marrë parasysh rëndësinë e të dhënave të hapura të qeverisë për hapjen dhe llogaridhënien, ky raport synon të kuptojë stadin më të avancuar të digjitalizimit në institucionet publike qendrore të Kosovës dhe të kuptojë faktorët dhe barrierat parësore që ndikojnë në aftësinë e këtyre institucioneve për t'u shpërndarë të gjithë qytetarëve informata të përgjithshme institucionale.

Hapat e ndjekur për kryerjen e këtij hulumtimi janë si më poshtë:

**Hapi 1.** U realizua hulumtimi për përdorimin e të dhënave nga institucionet publike qendrore të Kosovës;

**Hapi 2.** U realizua hulumtimi për të krahasuar përdorimin e të dhënave nga institucionet publike qendrore të Kosovës me ato në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut;

**Hapi 3.** U zhvilluan intervistat për të thelluar të kuptuarit e përdorimit të të dhënave në institucionet kryesore publike në Kosovë.

Më poshtë jepet një listë e detajuar e hapave për të aplikuar modelin e hulumtimit.

### **HAPI 1. Hartëzimi i të dhënave të prodhuara në institucionet publike qendrore në Kosovë:**

Lista e plotë e institucioneve qendrore është marrë nga burime të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë ministritë e linjës, agjencitë dhe organet e tjera publike (shih Aneksin 1).

- Kjo gjeneroi një përzgjedhje prej 53 institucioneve për Kosovën.
- Secili institucion u kontrollua për raporte strategjike, plane veprimi, dokumente dhe formate të tjera për të dhëna të hapura, duke kërkuar TKP-të.
  - Dokumentet e mbledhura u kategorizuan sipas institucionit, lokacionit, llojit dhe vitit të publikimit.
    - Si rregull, u konsideruan vetëm dokumentet nga viti 2019 deri në vitin 2022.
    - Në disa raste, ku informacioni ishte i pakët, u konsideruan edhe dokumente të vjetra.
  - TKP-të e gjetura në dokumente u kategorizuan sipas llojit, institucionit dhe lokacionit, si dhe:
    - Burimit (qoftë ky tregues i ASK-së apo nga burime të tjera;
    - Një klasifikimi të bazuar në kategoritë makro të përdorura nga ASK-ja dhe disa kategorizime shtesë të bazuara në ASK për ta interpretuar më mirë natyrën e të dhënave.

### **HAPI 2. Pasqyra krahasuese e të dhënave në tri vende të Ballkanit Perëndimor dhe identifikimi i hendekëve të të dhënave që ekzistojnë në Kosovë:**

U përzgjodhën nëntë institucione të tjera nga tri vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi (shih Aneksin 2).

Për secilin nga tri vendet, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë u zgjodhën si bazë për krahasim për shkak të numrit të lartë të raporteve dhe TKP-ve të gjetura në institutet përkatëse në Kosovë.

- Secili institucion u kontrollua për raporte strategjike, plane veprimi, dokumente dhe formate të tjera për të dhëna të hapura, duke kërkuar TKP-të.
- Dokumentet e mbledhura u kategorizuan sipas institucionit, lokacionit, llojit dhe vitit të publikimit.
  - Si rregull, u konsideruan vetëm dokumentet nga viti 2019 deri në vitin 2022.
  - Në disa raste, ku informacioni ishte i pakët, u konsideruan edhe dokumente më të vjetra.
- TKP-të e gjetura në dokumente u kategorizuan sipas llojit, institucionit dhe lokacionit si dhe:
  - Burimit (qoftë ky tregues i ASK-së apo të tjera);
  - Një klasifikimi të bazuar në kategoritë makro të përdorura nga ASK-ja dhe disa kategorizime shtesë të bazuara në ASK për ta interpretuar më mirë natyrën e të dhënave.

### **HAPI 3. Analiza e shkaqeve të përdorimit të pakët të të dhënave dhe sistemeve për ndarje të të dhënave, dhe qasjet e rekomanduara për ta përmirësuar mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave**

Ky hap i fundit bazohet në sa më lart dhe trajton:

- vlerësimin e shkaqeve të përdorimit të pakët të të dhënave në politikëbërje;
- analizën e sistemeve ekzistuese për ndarje të të dhënave, me rekomandime për sistemet apo mekanizmat e mundshëm për të lehtësuar ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve publike qendrore dhe ASK-së;
- rekomandim për qasjet për të përmirësuar mbledhjen, digjitalizimin, ndarjen dhe përdorimin e të dhënave për politikëbërje në mbarë institucionet publike qendrore të Kosovës.

Për t'i kuptuar më mirë pikat e mësipërme, u ndoq një qasje cilësore duke aplikuar një grup të intervistave me përfaqësues kyç nga institucione të ndryshme publike në Kosovë. U mbledh një listë e kontakteve nga të gjitha institucionet e përfshira në studim. Ato përfshinin:

- Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive të linjës;
- Drejtorët e Agjencive Publike;
- Kontaktet personale.



**Aneksi 2. Lista e institucioneve publike qendrore të Kosovës**

Lloji	Vartësia	Komente	Nr. i dokumenteve	Nr. i TKP-ve	Rubrikat e kontrolluara	Ueb faqja
<b>Presidenca e Kosovës</b>		- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0	- U kontrolluan rubrika të ndryshme, por nuk u gjetën raporte apo plane strategjike	<a href="https://president-ksgov.net/">https://president-ksgov.net/</a>
<b>Kuvendi i Kosovës</b>			2	4	- U kontrolluan seksione të ndryshme, por nuk u gjetën raporte apo plane strategjike - Raporte <a href="https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/raportet-e-legjislativave-te-kuvendit/">https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/raportet-e-legjislativave-te-kuvendit/</a> (të vjetëruara)	<a href="https://www.kuvendikosoves.org/">https://www.kuvendikosoves.org/</a>
<b>Ministria e Drejtësisë</b>		- Nuk ka përmbajtje statistikore në ueb faqe - Nuk publikohen raporte në ueb faqe - U kontrollua fusha e DOKUMENTEVE deri për vitin 2020	5	15	- Shpallje & Publikime <a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46</a> - Lajme dhe Ngjarje <a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15</a>	<a href="https://md.rks-gov.net/">https://md.rks-gov.net/</a>
<b>Avokatura Shtetërore e Kosovës</b>	Ministria e Drejtësisë	- Një rubrikë më një raport statistikor prej tri faqesh	1	3	- Dokumente <a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22</a> -	<a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22</a>
<b>Shërbimi Korrektues i Kosovës</b>	Ministria e Drejtësisë	- Rubrika për statistika në ueb faqe është jashtë funksioni	0	0	- Rubrika për statistika: Publikimet --> Statistikat <a href="https://shkk.rks-gov.net/publikimet/472/statistikat/472">https://shkk.rks-gov.net/publikimet/472/statistikat/472</a>	<a href="https://shkk.rks-gov.net/">https://shkk.rks-gov.net/</a>
<b>Shërbimi Spruvues i Kosovës</b>	Ministria e Drejtësisë	- Në ueb faqe nuk ka informacion statistikor - Ueb faqja është rubrikë në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë	0	0		<a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,19">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,19</a>
<b>Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar</b>	Ministria e Drejtësisë	- Në ueb faqe nuk ka informacion statistikor - Ueb faqja është rubrikë në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë	0	0		<a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,17">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,17</a>
<b>Instituti i Mjekësisë Ligjore</b>	Ministria e Drejtësisë	- Në ueb faqe nuk ka informacion statistikor - Ueb faqja është rubrikë në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë	0	0		<a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,20">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,20</a>

<b>Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë</b>	Ministria e Drejtësisë	<p>- Në ueb faqe nuk ka informacion statistikor</p> <p>- Ka vetëm një raport për vitin 2014, por vegza është jashtë funksioni <a href="http://www.md-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_24022015.pdf">http://www.md-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_24022015.pdf</a></p> <p>- Ueb faqja është rubrikë në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë</p>	0	0	<p>- Raporti 2014 (vegza është jashtë funksioni) <a href="http://www.md-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_24022015.pdf">http://www.md-ks.net/repository/docs/RAPORTI_2014_24022015.pdf</a></p>	<a href="https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,28">https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,28</a>
<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>		<p>- Statistika të ndryshme të mbledhura</p>	11	61	<p>- Rubrika për dokumentet <a href="https://mpb.rks-gov.net/f/39/Strategic-documents">https://mpb.rks-gov.net/f/39/Strategic-documents</a></p> <p>- Rubrika për publikimet <a href="https://mpb.rks-gov.net/f/40/Publications">https://mpb.rks-gov.net/f/40/Publications</a></p>	<a href="https://mpb.rks-gov.net/">https://mpb.rks-gov.net/</a>
<b>Policia e Kosovës</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>- Statistika të ndryshme të mbledhura</p>	5	4	<p>- Rubrika për dokumentet <a href="https://www.Kosovopolice.com/dokumente/dokumentet-strategjike/">https://www.Kosovopolice.com/dokumente/dokumentet-strategjike/</a></p>	<a href="https://www.Kosovopolice.com/">https://www.Kosovopolice.com/</a>
<b>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>- Në ueb faqe nuk ka informacion statistikor</p>	1	0	<p>- Rubrika për dokumentet <a href="http://aksp-ks.net/?page=1,246">http://aksp-ks.net/?page=1,246</a></p>	<a href="http://aksp-ks.net/">http://aksp-ks.net/</a>
<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>- Ka disa të dhëna të brendshme</p> <p>- Jo të dobishme për krahasim me ASK-në</p>	2	11	<p>- Rubrika e raporteve të inspektimit <a href="https://ipk.rks-gov.net/raportet/raporte-inspektimi/">https://ipk.rks-gov.net/raportet/raporte-inspektimi/</a></p> <p>- Raporte vjetore <a href="https://ipk.rks-gov.net/raportet/raporte-vjetore/">https://ipk.rks-gov.net/raportet/raporte-vjetore/</a></p> <p>- Raporte të tjera <a href="https://ipk.rks-gov.net/raportet/raporte-tjera/">https://ipk.rks-gov.net/raportet/raporte-tjera/</a></p>	<a href="https://ipk.rks-gov.net/">https://ipk.rks-gov.net/</a>
<b>Agjencia e Regjistrimit Civil</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>- Në rubrikën e ueb faqes është e disponueshme vetëm faqja në Facebook</p> <p>- Nuk ka të dhëna</p>	0	0	<p>- Faqja në Facebook <a href="https://www.facebook.com/profile.php?id=100066412395049">https://www.facebook.com/profile.php?id=100066412395049</a></p>	<a href="https://mpb.rks-gov.net/f/16/Agjencia-per-Regjistrim-Civil">https://mpb.rks-gov.net/f/16/Agjencia-per-Regjistrim-Civil</a>
<b>Agjencia e Menaxhimit Emergjent</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>- Ka statistika të ndryshme</p>	3	12	<p>- Dokumente <a href="https://ame.rks-gov.net/page/en-us/risk-assessment">https://ame.rks-gov.net/page/en-us/risk-assessment</a></p>	<a href="https://ame.rks-gov.net/">https://ame.rks-gov.net/</a>
<b>Agjencia e Kosovës për Forenzikë</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	<p>- Nuk ka TKP</p>	1	0	<p>- Rubrika për dokumente <a href="https://akf.rks-gov.net/StrategicDocuments.aspx">https://akf.rks-gov.net/StrategicDocuments.aspx</a></p>	<a href="https://akf.rks-gov.net/">https://akf.rks-gov.net/</a>

## HARTËZIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ZHVILLIM/

KAPACITETE TË ZGJERUARA INSTITUCIONALE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË KOSOVË

<b>Agjencia për Shoqëri të Informacionit (ASHI)</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	- Nuk ka TKP	0	0	- Nuk ka rubrikë për dokumentet	<a href="https://mpb.rks-gov.net/ap/page.aspx?id=1,14">https://mpb.rks-gov.net/ap/page.aspx?id=1,14</a>
<b>Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	- Nuk ka TKP	2	0	- Dokumente <a href="https://ikap.rks-gov.net/publication-details/38">https://ikap.rks-gov.net/publication-details/38</a>	<a href="https://ikap.rks-gov.net/">https://ikap.rks-gov.net/</a>
<b>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve</b>		- Ka TKP të ndryshëm	4	50	- Strategjia e Borxhit Publike <a href="https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49">https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,49</a> - Raporte dhe Publikime të tjera <a href="https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33">https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,33</a> - "Programi Kombëtar për Reforma në Ekonomi" <a href="https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,28">https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,28</a> - Dokumente për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave <a href="https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,117">https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,117</a>	<a href="https://mf.rks-gov.net/">https://mf.rks-gov.net/</a>
<b>Dogana e Kosovës</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	- Statistikat nga të dhënat e hapura përfshijnë një grup të skedarëve në Excel për bilancet tregtare, ndikimin e CEFTA-s, MSA-së, kohën optimale të zhdoganimit.	2	4	- Statistika nga të dhënat e hapura <a href="https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/statistikat-dhe-arritjet/">https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/statistikat-dhe-arritjet/</a> - Plani Strategjik <a href="https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/plani-strategjik/">https://dogana.rks-gov.net/per-doganen/plani-strategjik/</a>	<a href="https://dogana.rks-gov.net/">https://dogana.rks-gov.net/</a>
<b>Administrata Tatimore e Kosovës</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	- Ueb faqja është jashtë funksioni	0	0		<a href="http://www.atk-ks.org/">http://www.atk-ks.org/</a>
<b>Njësia për Inteligjencë Financiare</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	- Rubrika për statistika ekziston por nuk është e përditësuar	1	1	- Raporti Vjetor <a href="https://fiu.rks-gov.net/publications/#section_1">https://fiu.rks-gov.net/publications/#section_1</a>	<a href="https://fiu.rks-gov.net/">https://fiu.rks-gov.net/</a>
<b>Agjencia Qendrore e Prokurimit</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	- Numër i ulët i të dhënave	1	1	- Raportet <a href="https://aqp.rks-gov.net/raportet/">https://aqp.rks-gov.net/raportet/</a>	<a href="https://aqp.rks-gov.net/">https://aqp.rks-gov.net/</a>
<b>Bordi Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0	- Ueb faqja është nën-rubrikë në ueb faqen e Ministrisë	<a href="https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,183">https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,183</a>
<b>Agjencia e Statistikave të Kosovës</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	NUK ËSHTË KONSIDERUAR	0	0	NUK ËSHTË KONSIDERUAR	<a href="https://ask.rks-gov.net/">https://ask.rks-gov.net/</a>

**HARTËZIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ZHVILLIM/  
KAPACITETE TË ZGJERUARA INSTITUCIONALE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË KOSOVË**

<b>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</b>		- Nuk ka dokumente me TKP	0	0	- Publikime <a href="https://www.mkrs-ks.org/?page=1,27">https://www.mkrs-ks.org/?page=1,27</a> - Raporte <a href="https://www.mkrs-ks.org/?page=1,26">https://www.mkrs-ks.org/?page=1,26</a>	<a href="https://www.mkrs-ks.org/">https://www.mkrs-ks.org/</a>
<b>Ministria e Ekonomisë</b>		- Dokumentet në rubrikat e raporteve dhe strategjive janë të vjetëruara  - Nuk mblidhen TKP	1	0	- Energjia - Strategjitë <a href="https://me.rks-gov.net/sq/energjia-5">https://me.rks-gov.net/sq/energjia-5</a> - Energjia - Publikime <a href="https://me.rks-gov.net/sq/publikime">https://me.rks-gov.net/sq/publikime</a>  - Minierat - Strategjitë <a href="https://me.rks-gov.net/sq/strategjite-210">https://me.rks-gov.net/sq/strategjite-210</a>	<a href="https://me.rks-gov.net/">https://me.rks-gov.net/</a>
<b>Shërbimi Gjeologjik i Kosovës</b>	Ministria e Ekonomisë	- Nën-rubrikë në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë  - Nuk ka raporte / të dhëna	0	0	- Nuk ka informata	<a href="https://me.rks-gov.net/sq/agjencite#.Yrr3UexBw-Q">https://me.rks-gov.net/sq/agjencite#.Yrr3UexBw-Q</a>
<b>Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë</b>	Ministria e Ekonomisë	- Ka TKP nga ASK-ja	1	19	- Dokumente <a href="https://akee.rks-gov.net/publikime-shpallje/">https://akee.rks-gov.net/publikime-shpallje/</a>	<a href="https://akee.rks-gov.net/publikime-shpallje/">https://akee.rks-gov.net/publikime-shpallje/</a>
<b>Muzeu i Kristaleve dhe Mineraleve - TREPÇA</b>	Ministria e Ekonomisë	- Nën-rubrikë në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë  - Nuk ka raporte / të dhëna	0	0	- Nuk ka informata	<a href="https://me.rks-gov.net/sq/muzeu-shteteror-i-kristaleve-dhe-mineraleve---trepca#.Yrr4nuxBw-Q">https://me.rks-gov.net/sq/muzeu-shteteror-i-kristaleve-dhe-mineraleve---trepca#.Yrr4nuxBw-Q</a>
<b>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</b>		- Rubrika për strategjitë është e vjetëruar (dokumenti i fundit nga viti 2017)  - Informata të mbledhura nga përmbajtja statistikore  - Nuk ka tregues të qartë të ASK-së, por referencë për metodologjinë e ASK-së	2	26	- Strategjitë <a href="https://masht.rks-gov.net/category/dokumente/strategjite/">https://masht.rks-gov.net/category/dokumente/strategjite/</a> (të vjetëruara)  - Statistikat <a href="https://masht.rks-gov.net/category/dokumente/statistikat/">https://masht.rks-gov.net/category/dokumente/statistikat/</a>	<a href="https://masht.rks-gov.net/en">https://masht.rks-gov.net/en</a>
<b>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</b>		- Ueb faqja është jashtë funksioni	0	0		<a href="https://mapl.rks-gov.net/">https://mapl.rks-gov.net/</a>
<b>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</b>		- Nuk ka dokumente të përditësuara në ueb faqe	0	0	- Strategjitë <a href="https://www.mit-ks.net/sq/strategjite">https://www.mit-ks.net/sq/strategjite</a> (nuk ka dokumente të përditësuara)  - Dokumente <a href="https://www.mit-ks.net/sq/dokumente-berzh---Kosovoads-project-lap">https://www.mit-ks.net/sq/dokumente-berzh---Kosovoads-project-lap</a> (nuk ka dokumente të përditësuara)	<a href="https://www.mit-ks.net/">https://www.mit-ks.net/</a>
<b>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</b>		- Nuk ka dokumente me të dhëna	1	0	- Grante <a href="https://www.mbpzhr-ks.net/sq/grante">https://www.mbpzhr-ks.net/sq/grante</a>	<a href="https://www.mbpzhr-ks.net/">https://www.mbpzhr-ks.net/</a>

## HARTËZIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ZHVILLIM/

KAPACITETE TË ZGJERUARA INSTITUCIONALE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË KOSOVË

<b>Agjencia e Pyjeve të Kosovës</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0		<a href="https://apk-rks.net/">https://apk-rks.net/</a>
<b>Agjencia për Zhvillim Bujqësor</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0		<a href="https://www.azhb-ks.net/sq/ballina">https://www.azhb-ks.net/sq/ballina</a>
Ministria e Shëndetësisë		- Dokumente me të dhëna të vjetëruara	2	0	- Dokumente <a href="https://msh.rks-gov.net/sq/strategjite/">https://msh.rks-gov.net/sq/strategjite/</a> - Raporte <a href="https://msh.rks-gov.net/sq/publikimet/raportet/">https://msh.rks-gov.net/sq/publikimet/raportet/</a> (nuk ka dokumente me të dhëna)	<a href="https://msh.rks-gov.net/sq/">https://msh.rks-gov.net/sq/</a>
<b>Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale</b>	<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0		<a href="https://msh.rks-gov.net/sq/agjensioni-per-produkte-dhe-pajisje-mjekesore/">https://msh.rks-gov.net/sq/agjensioni-per-produkte-dhe-pajisje-mjekesore/</a>
<b>Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës</b>	<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	- Nuk ka dokumente me të dhëna	1	0	- Publikime <a href="https://niph-rks.org/per-ikshpk/publikime/">https://niph-rks.org/per-ikshpk/publikime/</a>	<a href="https://niph-rks.org/">https://niph-rks.org/</a>
<b>Agjencia për Financim të Shëndetësisë</b>	<b>Ministria e Shëndetësisë</b>		0	0		
<b>Inspektorati Shëndetësor</b>	<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0		<a href="https://msh.rks-gov.net/sq/inspektorati-shendetesor/">https://msh.rks-gov.net/sq/inspektorati-shendetesor/</a>
<b>Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</b>		- Nuk publikohen raporte, strategji në ueb faqe	0	0	- Publikime <a href="https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,124">https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,124</a> (faqe e zbrazët)	<a href="https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43">https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,43</a>
<b>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës - ARBK</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- Ka disa TKP por janë me llogaritje vetanake	1	7	- Raporte <a href="https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,41">https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,41</a> - Dokumente <a href="https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,5">https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,5</a> (faqe e zbrazët)	<a href="https://arbk.rks-gov.net/">https://arbk.rks-gov.net/</a>
<b>Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- ka një TKP; nuk lidhet me ASK-në	1	1	- Publikime Gjenerale <a href="https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,109">https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,109</a> - Raporte sektoriale <a href="https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,111">https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,111</a> (të vjetëruara) - Raporte të ndryshme <a href="https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,112">https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,112</a>	<a href="https://kiesa.rks-gov.net/">https://kiesa.rks-gov.net/</a>
<b>Inspektorati i Tregut - IT</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0	- Raporte <a href="https://it.rks-gov.net/page.aspx?id=1,7">https://it.rks-gov.net/page.aspx?id=1,7</a> (nuk funksionon)	<a href="https://it.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1">https://it.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1</a>
<b>Agjencia Kosovare për Standardizim - AKS</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- Nuk ka dokumente me të dhëna	2	0	- Publikime <a href="https://aks.rks-gov.net/button_61.html">https://aks.rks-gov.net/button_61.html</a>	<a href="https://aks.rks-gov.net/">https://aks.rks-gov.net/</a>

**HARTËZIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ZHVILLIM/  
KAPACITETE TË ZGJERUARA INSTITUCIONALE PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË KOSOVË**

<b>Agjencia e Metrologjisë së Kosovës - AMK</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0		<a href="https://amk.rks-gov.net/">https://amk.rks-gov.net/</a>
<b>Agjencia e Pronësisë Industriale - API</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- Nuk ka dokumente me të dhëna	0	0		<a href="https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,65">https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,65</a>
<b>Drejtoria e Akreditimit e Kosovës - DAK</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	- Nuk ka dokumente me të dhëna	1	0	- Publikime <a href="https://dak.rks-gov.net/page.aspx?id=1,4">https://dak.rks-gov.net/page.aspx?id=1,4</a>	<a href="https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,61">https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,61</a>
<b>Ministria e Zhvillimit Rajonal</b>			4	21	- Koncept dokumente <a href="https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,14">https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,14</a> - Strategji <a href="https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,14">https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,14</a> - Politika zhvillimore <a href="https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,16">https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,16</a> (faqe e zbrazët) - Raporte vjetore <a href="https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,61">https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,61</a>	<a href="https://mzhr.rks-gov.net/">https://mzhr.rks-gov.net/</a>
<b>Ministria e Mbrojtjes</b>		- Ueb faqja duket jashtë funksioni - Rubrika për dokumente është jashtë funksioni - I vetmi dokument që ka është Strategjia e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, në Zyrën për Qeverisje të Mirë, si draft konsultativ. - Nuk përdoren të dhëna në këtë dokument	1	0	- Dokumente <a href="https://mod.rks-gov.net/shpallje/dokumente/">https://mod.rks-gov.net/shpallje/dokumente/</a> (jashtë funksioni)	<a href="https://mod.rks-gov.net/">https://mod.rks-gov.net/</a>
<b>Këshilli Gjyqësor i Kosovës</b>		- Informacioni kryesor vjen nga rubrika për Publikimet - Janë konsideruar vetëm raportet e vitit 2022, pasi struktura është e njëjtë edhe për vitet e tjera	4	21		<a href="https://www.gjyqesori-rks.org/?lang=en">https://www.gjyqesori-rks.org/?lang=en</a>
<b>Këshilli Prokurorial</b>			1	5	- Dokumente strategjike <a href="https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/86/121/652/652/">https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/86/121/652/652/</a> - Raporte <a href="https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/84/89/649/649/">https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/84/89/649/649/</a>	<a href="https://prokuroria-rks.org/kpk">https://prokuroria-rks.org/kpk</a>

**Aneksi 3. lista e dokumenteve për institucionet e Kosovës**

Nr.	Emri i dokumentit	Nr. i TKP-ve	Institucioni	Lloji	Viti	URL
1	Plani Strategjik i Sistemit Prokurorial 2022-2024	5	Këshilli Prokurorial	Raport Strategjik	2022	<a href="https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/PLANI%20STRATEGJIK%20I%20SISTEMIT%20PROKURORIAL%20(2022-2024).pdf">https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/PLANI%20STRATEGJIK%20I%20SISTEMIT%20PROKURORIAL%20(2022-2024).pdf</a>
2	Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës	0	Kuvendi i Kosovës	Raport Strategjik	2022	<a href="https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2019_02_08_StrategjiaperinformimdhekomunikimeKuvenditteRepublikesseKosoves'(1)_BH22KECCKL.pdf">https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2019_02_08_StrategjiaperinformimdhekomunikimeKuvenditteRepublikesseKosoves'(1)_BH22KECCKL.pdf</a>
3	Raporti i Punës së Kuvendit të Kosovës për legjislaturën V, 2014 - 2017	4	Kuvendi i Kosovës	Raport	2022	<a href="https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/12/1.LegjislaturaeV-RaportiiPunesseKK-VERSIONIFINAL-Shqipdhelek-QERSHOR2017(1)_n8G9EbPvd6.docx">https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/12/1.LegjislaturaeV-RaportiiPunesseKK-VERSIONIFINAL-Shqipdhelek-QERSHOR2017(1)_n8G9EbPvd6.docx</a>
4	Raporti për shpenzimet javore	1	Ministria e Drejtësisë	Raport	2022	<a href="https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E52FF851-AE3A-4F00-9E22-ADBD3BAD1280.xlsx">https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E52FF851-AE3A-4F00-9E22-ADBD3BAD1280.xlsx</a>
5	Koncept dokumenti për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë	4	Ministria e Drejtësisë	Koncept Dokument	2021	<a href="https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/09E907A6-06B2-4DBF-AB8B-E2793F4B9049.pdf">https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/09E907A6-06B2-4DBF-AB8B-E2793F4B9049.pdf</a>
6	Strategjia për Sundimin e Ligjit	3	Ministria e Drejtësisë	Raport Strategjik	2021	<a href="https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC-1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf">https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC-1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf</a>
7	Plani i Veprimit korrik 2021	0	Ministria e Drejtësisë	Plani i veprimit	2021	<a href="https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/149A80F7-A7B6-40CF-B388-2F9471E8237D.xlsx">https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/149A80F7-A7B6-40CF-B388-2F9471E8237D.xlsx</a>
8	Raporti i Punës i Ministrisë së Drejtësisë	7	Ministria e Drejtësisë	Raport	2020	<a href="https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8FA56F12-23AC-4DEE-9150-1E25A527D485.pdf">https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8FA56F12-23AC-4DEE-9150-1E25A527D485.pdf</a>
9	Raport statistikor për punën e Avokaturës Shtetërore	3	Avokatura Shtetërore	Raport Statistikor	2020	<a href="https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2EF405F5-1FCF-47C5-91A4-F89A0E007F10.pdf">https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2EF405F5-1FCF-47C5-91A4-F89A0E007F10.pdf</a>
10	Paneli i Performancës	4	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Rubrika e ueb faqes	2022	<a href="https://www.gjyqesori-rks.org/performance-dashboard/?lang=en">https://www.gjyqesori-rks.org/performance-dashboard/?lang=en</a>
11	Raporti i punës për vitin 2021	7	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Raporti vjetor.	2022	<a href="https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/4620_KGJK_Raporti_Punes_2021.pdf">https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/4620_KGJK_Raporti_Punes_2021.pdf</a>
